



01 Nr. 553/25 Dt. 18.09.2025



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**  
**Opština Prizren – Prizren Beledijesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejin e rregullimit të transportit linjor urban-periferik në relacionin Velezhë-Smaç-Shpenadi dhe anasjelltas, kështu që, për këtë qëllim lejohet zhvillimi i procedurave ligjore-shpallja publike për rregullimin e këtij transporti.
2. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
  - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Arkivës së Kryetarit.

